492	Lazi	Miti	4397 6-4411 6	94/45	3695	424.217	1000	424217	27574	451791	
493	Vasil	Miti	4411 6-4432 3	94/48	3695	622.248	1000	622248	9334	631581	
494	Kristaq	Pali	4432 3-4448 6	94/49	3695	483.900	1000	483900	45000	528900	
495	Vangjel	Vani	4448 6-4467 5	94/51	3695	554.329	1000	554329	8315	577644	
496	Loni	Vani	4467 5-4486 1	94/53	3695	540.484	1000	540484	35131	575615	

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE
AUTOSTRADES LUSHINJE-FIER
(Faza e dyte)

Udhëzime pasurisë së pallojtshme: Tole bujqesore, Objekt, Kulture Bujqesore dhe Dru Frutore.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	PRONAR	MATJE	Nr. i pasurisë	Nr. i z. Kadas.	Sipërfaqe	Cmimi	Vlera (Lek)	Vlera (Lek)	Vlera (Lek)	Totali	Shenime
Nr.	Emri	Adresa	Vendimi	Paket	Nr. i pasurisë	Nr. i z. Kadas.	Sipërfaqe	m²	Udhëzime pasurisë së pallojtshme	Dru Frutore	Shenime
497	Viktor	Monoli	7/11/13	4494 1-4519 5	94/55	3695	976 196	1000	976196	100000	1076196
498	Kostandin	Loni	7/11/13	4530 6-4554 9	111/13	3695	174 735	1000	174735		183472
499	Vani	Pilo	7/11/13	4530 6-4554 9	111/13	3695	692 655	1000	692655		692655
500	Shahin	Nexhip	7/11/13	4554 9-4566 8	111/15	3695	409 763	1000	409763		415909
501	Xhevit	Nexhip	7/11/16	4566 8-4577 0	111/16	3695	341 401	1000	341401		348522
502	Lirimi	Ramiz	7/11/18	4577 0-4587 1	111/18	3695	326 439	1000	326439		331336
503	Batllar	Petref	7/11/20	4587 1-4598 0	111/20	3695	337 651	1000	337651		354533
504	Flip	Loni	7/11/21	4598 0-4620 4	111/21	3695	683 017	1000	683017		717167
505	Llamber	Loni	7/11/23	4620 4-4642 1	111/23	3695	636 790	1000	636790	40000	676790
506	Nesti	Mina	7/11/24	4642 1-4645 2	111/24	3695	278 856	1000	278856		292798
507	Naizmi	Ramis	7/10/4	4623 0-4665 8	110/4	3695	101 542	1000	101542		106619
508	Sotraq	Loni	7/11/25	4645 2-4666 4	111/25	3695	246 353	1000	246353		250048
509	Thoma	Llazi	7/11/27	4665 4-4684 22	111/27	3695	354 142	1000	354142		359454
510	Fuat	Myslym	7/11/5	4665 8-4687 0	110/5	3695	167 672	1000	167672		170187
511	Llazi	Zarif	7/11/30	4684 22-4708 9	111/30	3695	419 670	1000	419670		425965
512	Andrea	Llazi	7/11/31	4708 9-4728 0	111/31	3695	279 278	1000	279278		283467
513	Todi	Kristo	7/11/6	4697 0-4731 0	110/6	3695	244 076	1000	244076		247737
514	Llamber	Loni	7/13/21	4733 17-4750 0	133/21	3695	268 667	1000	268667		272697
515	Loni	Lami	7/13/21	4733 17-4750 0	134/1	3695	93 628	1000	93628		95033
516	Dhimitraq	Liko	7/13/22	4750 0-4773 3	133/22	3695	432 961	1000	432961		439455
517	Filim	Fasli	7/13/2	4750 0-4775 0	134/2	3695	164 257	1000	164257		166721
518	Zarif	Kozma	7/13/23	4773 3-4788 1	133/23	3695	271 160	1000	271160		275228
519	Aristir	Liko	7/13/24	4788 1-4803 6	133/24	3695	279 082	1000	279082		283268
520	Thoma	Llazi	7/13/3	4775 0-4806 3	134/3	3695	268 251	1000	268251		272275
521	Pandi	Mina	7/13/25	4803 6-4817 8	133/25	3695	250 335	1000	250335		254090
522	Irakli	Todi	7/13/26	4817 8-4839 4	133/26	3695	364 191	1000	364191		369654
523	Arben	Hamza	7/13/44	4805 3-4839 9	134/44	3695	336 976	1000	336976		353825
524	Gori	Themil	7/13/27	4839 4-4872 5	133/27	3695	527 898	1000	527898		554293
525	Gori	Themil	7/13/5	4839 4-4866 5	134/5	3695	307 168	1000	307168		311776
526	Marko	Themil	7/13/28	4872 5-4887 5	133/28	3695	354 785	1000	354785		372524
527	Marko	Themil	7/13/6	4885 5-4899 0	134/6	3695	554 293	1000	554293	90000	644293

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
REJTORIA JURIDIKE
RETHI LUSHNJË - FIER

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDETIMIT TE
AUTOSTRADES LUSHNJË-FIER
(Faza e dyte)

Udhë i pasurisë së pajutshme: Toka bujqësore, Objekt, Kulture Bujqësore dhe Dru Frutore.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	PRONAR	MATJE	Nr. 1 pasurisë	Nr. 1 z. Kadastr.	Superfaqe	Cmimi	Vlera (Lek)	Vlera (Lek)	Vlera (Lek)	Totali	Shënime
Nr	Emri	Adresa	Piketi	Nr. 1 pasurisë	m ²	L/m ²	Sip. tokës/objekt	Kulture bujqësore	Dru Frutore	8+9+10+11	Shënime
528	Vangjel	Gori	Hila	4897 5-4818.8	133.30	3695	290 513	14526		305039	Plotesim Dokumentacioni
529	Alfred	Gori	Hila	4818 8-4856.2	133.31	3695	412 628	1000	10000	428818	Plotesim Dokumentacioni
530	Mina	Llambi	Sota	4908 0-4985.0	137.7	3695	921 330	1000		935150	Plotesim Dokumentacioni
531	Vasil	Miti	Semini	4956 2-4879.5	133.32	3695	210 989	1000		214154	Plotesim Dokumentacioni
532	Petro	Vasil	Semini	4878 5-5067.7	133.33	3695	184 104	1000	50000	234104	
533	Anesti	Mina	Sota	4968 0-5012.2	134.8	3695	920 463	1000		934270	
534	Vasil	Miti	Semini	5011 4-5053.3	132.4	3695	359 828	1000		365225	
535	Anesti	Mina	Sota	5014 8-5050.5	131.1	3695	809 137	1000		821274	Plotesim Dokumentacioni
536	Mina	Llambi	Sota	5014 8-5050.5	131.2	3695	813 133	1000		825330	Plotesim Dokumentacioni
537	Futro	Vasil	Semini	4993 3-5112.3	137.5	3695	121 573	1000	1824	123397	
538	Pandi	Mina	Sota	5050 5-5053.23	131.3	3695	772 723	1000		784314	
539	Spili	Thoma	Kuntakriu	5122 3-5159.6	130.1	3695	1334 153	1000	20012	1354166	
540	Hilli	Kroni	Kuntakriu	5159 6-5173.2	130.2	3695	463 378	1000		470328	
541	Friedi	Gori	Hila	5173 2-5203.1	130.3	3695	992 507	1000		1007395	Plotesim Dokumentacioni
542	Niko	Nasi	Nako	5208 5-5291.6	151.3	3695	669 769	1000	325000	1004815	
543	Vani	Nasi	Nako	5208 5-5333.0	151.4	3695	2621 865	1000		2661193	Plotesim Dokumentacioni
544	Vani	Nasi	Nako	5291 6-5333.0	151.5	3695	303 745	1000		308301	
545	Vani	Nasi	Nako	5335 0-5395.5	153.1	3695	1780 697	1000		1807408	
546	Nasi	Petro	Nako	5395 5-5482.5	153.2	3695	2825 675	1000		2868060	Plotesim Dokumentacioni
547	Niko	Nasi	Nako	5489 8-5618.0	154.1	3695	3906 974	1000		3965579	
548	Zylfytar	Hysen	Delibashi	5621 7-5788.1	155.1	3695	1760 706	1000		1848741	Plotesim Dokumentacioni
549	Alfred	Gori	Hila	5621 7-5788.1	155.2	3695	2218 394	1000		2284946	Plotesim Dokumentacioni
550	Tapi	Hysen	Delibashi	5770 3-5854.6	155.3	3695	2462 836	1000	18000	2603978	Plotesim Dokumentacioni
551	Tapi	Hysen	Delibashi	5860 7-5996.4	156.1	3695	3960 723	1000		4158760	Plotesim Dokumentacioni
552	Avni	Bato	Hajdari	6006 7-6124.9	31.1	2636	3432 700	1000		3484191	
553	Pellumb	Bato	Hajdari	6124 9-6319.0	31.2	2636	5644 400	1000		5729066	
554	Hajdari	Rauf	Hajdari	6319 0-6362.2	31.3	2636	1248 412	1000		1267138	Plotesim Dokumentacioni
555	Baram	Rauf	Hajdari	6362 2-6403.5	31.4	2636	1196 262	1000		1214206	Plotesim Dokumentacioni
556	Rauf	Hajdari	Hajdari	6403 5-6435.0	31.5	2636	913 013	1000		926708	Plotesim Dokumentacioni
557	Vera	Ilmi	Hajdari	6425 0-6456.1	31.6	2636	606 549	1000		615547	Plotesim Dokumentacioni
558	Haliti	Haxhi	Gashi	6458 1-6484.4	31.7	2636	1097 985	1000		1114455	

LISTA E PROMAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDETIMIT TE
AUTOSTRADES LUSHNJE-FIER

(Faza e dyte.)

Lloji i pasurise se paltuajtshme: Tokë bujqësore, Objekt, Kulture Bujqësore dhe Dru Frutore.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	PRONAR				Sipërfaqe	Cmimi	Vlera (Lek)	Vlera (Lek)	Vlera (Lek)	Totali	Shenime
Nr	Emri	Atesia	Mbierm					Kulture bujqësore	Dru Frutore	8+9+10+11	Shenime
				Nr. i pasurise z Kadas	m ²	L/m ²	Sipërfaqe/objekt				
559	Agrosh	Ylli	Agallid	31/7	2636						
560	Gavrosh	Xhndole	Xhndole	149/5	2999	708 000	750	531000		531000	Proces Rregjistrimi
	Therri	Kristo	Ndreka	56/1	1197	383 000	1000	383000		383000	
		Shuma	3			207316.853		207139853	1968700	213882770	
		Shuma	(1+2+3)					247196421	2200025	254960831	
561	Andon	Rako	Llazi	50/2	1197	objekt/	prev	6503732		6503732	Proc Gjyq vert fakti pronesia
562	Ndricim	Mersin	Gafka			110/30	2465271226	3081500		3081500	Proc Gjyq vert fakti pronesia
563	Laureta	Ndricim	Gafka			125/27	24652	3747104		3747104	Proc Gjyq vert fakti pronesia
		Shuma	4					13332336		13332336	
ma (1+2+3+4)	Faza e dyte							260828757	2200025	268293167	

TABELA NR. 1

Lista e Objekteve te cilat nuk mund te realizohen per vitin 2005.
Vlera e financimit te ketyre objekteve do te perdoret per perballimin e pageses per efekt shpronesimi te pronareve, pronat e te cilet do te preken nga ndertimi i segmentit rrugor Lushnje – Fier (Faza e dyte)

							000/leke	
Gr	Tit	Kap	Art	Qark	Lok	Emertimi i Projektit	Fondi	Investitor
						Pakesohet	-64000	
8	011	1	231	3535	0	Pershtatje zyresh ne tarracen e MTT (shtese kati)	-6500	MTT
8	122	1	231	0821	0	Sistemim asfaltim Rruga Librazhd – Qafe Stude	-10000	DMRr Librazhd
8	122	1	231	3535	0	Shpenzime per kantierin e rruges Rrogozhine – Elbasan	-9000	DPRR
8	122	1	230	3535	0	Studime e projektme Masa inxhinerike rruga e Shishtavecit	-4000	DPRR
8	122	1	230	3535	0	Studime e projektme Sistemim asfaltim rruga e Traget - Fierze	-1000	DPRR
8	122	1	230	3535	0	Studim projektim Gjiri i Lalzit	-9500	DPRR
8	123	1	231	3535	0	Shtese zyresh ne katin e dyte	-12600	IST
8	123	1	231	3535	0	Makineri e paisje zyresh	-2400	IST
8	124	1	231	3737	0	Zgjerimi i kalates ne molin zero (faza e trete)	-9000	Porti Detar Vlore

VENDIM
Nr.782, datë 14.12.2005

PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT TË PIKTURËS “MOTRA TONE”, OBJEKT ME VLERA UNIKALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE KOMBËTARE, JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ekspozimit të pikturës “Motra Tone”, objekt me vlera unike të trashëgimisë kulturore kombëtare, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga muzeu C2RMF, Luvër, në muzeun D’Orsay, në Paris, Francë, nga datat 14-16 dhjetor 2005.

2. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet, në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.783, datë 14.12.2005

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 shkronja “c”, 20 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të neneve 82 e 85 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 2 të kreut I të këtij vendimi, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Përfashtim nga zbatimi i orarit të përcaktuar më lart bëjnë postet konsullore, në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, të Republikës së Shqipërisë (konsullatat e përgjithshme, konsullatat, nënkonsullatat dhe zyrat konsullore).

Në këto poste konsullore orari i punës të jetë:

- Çdo të mërkurë, të enjte, të shtunë dhe të dielë nga ora 9⁰⁰ deri në orën 14⁰⁰ dhe nga ora 14.30 deri në orën 17.30;

- Çdo të premte nga ora 14⁰⁰ deri në orën 22⁰⁰.”.

2. Në fund të pikës 1 të kreut II, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për postet konsullore, në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, të Republikës së Shqipërisë, (konsullatat e përgjithshme, konsullatat, nënkonsullatat dhe zyrat konsullore) ditët e pushimit javor janë vetëm dita e hënë dhe e martë e çdo jave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.787, datë 14.12.2005

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS
EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 19, pika 3, 20, pika 2, 29, pika 10, e 35 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Kriteret dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike

1. Përfitojnë ndihmë ekonomike:

- a) Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
- b) Jetimët e papunë, mbi 25 vjeç;
- c) Jetimët e moshës 18-25 vjeç, të cilët nuk janë të vendosur në institucionet e shërbimeve shoqërore ose nën kujdestari;

ç) Prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë, që u përkasin familjeve në nevojë.

2. Kryetari i familjes, që kërkon ndihmë ekonomike duhet të paraqesë pranë administratorit shoqëror të stacioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/komunë, ku ka vendbanimin, dokumentet e mëposhtme, së bashku me kërkesën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes:

a) Deklaratën për gjendjen social-ekonomike të familjes, sipas mod.1, që i bashkëlidhet vendimit, e cila plotësohet nga kryefamiljari, një herë në vit, si dhe në rastet kur familja përfituese rikthehet në skemën e ndihmës ekonomike;

b) Deklaratën sipas mod.2, që i bashkëlidhet vendimit, që plotësohet, detyrimisht, çdo muaj.

c) Certifikatën e gjendjes familjare, ku shënohen data e regjistrimit në regjistrin themeltar, vendbanimi i mëparshëm dhe ndryshime të tjera të familjes;

ç) Certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

d) Aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës (tapinë e tokës) për zonat, ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende. Pas përfundimit të regjistrimit të tokës edhe për këto zona do të jetë e vlefshme certifikata, e përcaktuar në shkronjën “ç” të kësaj pike;

dh) Vërtetimin si punëkërkuar të papunë, për të gjithë anëtarët e familjes, të aftë për punë, që aplikojnë për ndihmë ekonomike. Ky vërtetim lëshohet nga zyra e punës çdo tre muaj.

3. Familjet, që kanë vendbanimin në qytet, të regjistruara në zyrat e gjendjes civile pas datës 1 gusht 1991, të cilat vendbanimin e mëparshëm e kanë pasur në fshat, duhet të paraqesin, për të kërkuar ndihmë ekonomike, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, edhe këto dokumente:

a) Vërtetimin e nënshkruar dhe të vulosur nga kryetari i komunës a bashkisë (që në përbërje kanë fshatrat, banorët e të cilave janë trajtuar me tokë), nga kryetari i fshatit dhe përgjegjësi i zyrës së kadastrës, ku të thuhet se këto familje nuk disponojnë tokë në pronësi, sipas vendimit të komisionit të ndarjes së tokës, meqenëse janë larguar nga vendbanimi, para datës 1 gusht 1991, për arsye pune;

b) Kopjet e librezave të punës, të noterizuara, që vërtetojnë se pjesëtarë të tyre kanë qenë të punësuar nga çasti i largimit nga vendbanimi në fshat;

c) Certifikatën e pronësisë së tokës, kur kanë përfutur tokë.

4. Nëse familjet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, kanë dokumentet e përmendura në shkronjat “a” e “b” të pikës së sipërpërmendur, kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë ekonomike të plotë, ndërsa kur kanë dokumentet e përmendura në shkronjat “b” e “c”, kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë ekonomike të pjesshme.

5. Kur këto familje e ndryshojnë vendbanimin, ato duhet të paraqesin, brenda 30 ditëve, në vendbanimin e ri, një dokument, ku të vërtetohet se kanë përfutur ndihmë ekonomike në vendbanimin e mëparshëm.

6. Për kushte të veçanta social-ekonomike dhe shëndetësore të familjes, administratorët shoqërorë duhet të kërkojnë edhe dokumente shtesë, si vërtetimin për frekuentimin e shkollës, vendimin e gjykatës, raportin mjekësor etj.

7. Jetimët e moshës 18-25 vjeç, që janë të papunë, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të paraqesin edhe kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar.

8. Familjet e invalidëve të punës, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, duhet të paraqesin edhe kopjen e noterizuar të vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

9. Administratorët shoqërorë janë të detyruar që dokumentacionin e përcaktuar në shkronjat “c”, “d” e “e” të pikës 2 të këtij vendimi, ta ruajnë për të gjithë periudhën, gjatë së cilës familja përfiton ndihmë ekonomike.

10. Përfshihen nga përfitimi i ndihmës ekonomike familjet që kanë në përbërje edhe një anëtar të vetëm, që plotëson kushtet e mëposhtme, i cili:

a) është pronar i çdo lloji kapitali, me përjashtim të shtëpisë së banimit dhe të tokës bujqësore;

b) është ekonomikisht aktiv (punëdhënës, i punësuar ose i vetëpunësuar).

Përfshihen invalidët e punës, të verbërit, të paaftët, paraplegjikët dhe tetraplegjikët;

c) është jashtë shtetit për çdo arsye, me përjashtim të personave, që kryejnë studime ose janë për kurim dhe të personave, pjesëtarë të familjeve, të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare;

ç) nuk është i regjistruar si punëkërkuar i papunë.

Përfshihen, anëtarët e familjeve bujqësore, invalidët e punës, të verbërit, të paaftët, paraplegjikët dhe tetraplegjikët;

d) refuzon punën e ofruar nga zyra e punësimit, si pjesëmarrja në punë e shërbime në komunitet, që organizohen nga bashkia/komuna, apo që nuk pranon të marrë pjesë në kurset e formimit profesional, kur është i aftë dhe në moshë pune;

dh) ka refuzuar të marrë tokën e dhënë me ligjin nr.7501, datë 31.8.1991;

e) nuk e tërheq ndihmën ekonomike të miratuar nga këshilli bashkiak a i komunës, brenda 6 ditëve-pune nga data e caktuar nga banka, me përjashtim të rasteve të fatkeqësisë apo sëmundjeve, të vërtetuara me dokumente ligjore;

ë) ndërmerr veprime të qëllimshme për të përfituar ndihmë ekonomike të pamërituar, që nënkupton:

- Shmangie të qëllimshme nga punësimi dhe formimi profesional;

- Dhurim spekulativ të kapitaleve;

- Ndarje spekulative e një ose disa anëtarëve të familjes pas datës 1 korrik 1993, si dhe ndarjet gjatë procesit të legalizimit të banesave në zonat informale, me përjashtim të rasteve kur ndarja ka të bëjë me një kurorë të re apo me vajzë nënë;

- Braktisje dhe mosshfrytëzim të pronave dhe të burimeve të tjera të jetës;

- Moslejimin e administratorit shoqëror ose të personave të autorizuar për auditim për verifikimin apo intervistimin e tyre në zyrë a shtëpi.

- Ndryshimin e vendbanimit, me përjashtim të rasteve për shkak të detyrës shtetërore.

11. Kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë ekonomike të pjesshme familjet bujqësore që, në bazë të dokumenteve, kanë tokë në pronësi.

Përfshihen ato familje që:

a) edhe pse kanë përfituar tokë sipas ligjit, nuk e disponojnë për shkak të zënies së tokës apo për probleme të ndryshme pronësie;

b) kanë zënë forcërisht tokën e dikujt tjetër;

c) kanë shitur dhe blerë tokë ose marrin dhe e japin tokën me qira.

12. Trajtohen me ndihmë ekonomike të plotë familjet që:

a) kanë marrë tokë në zonat e kripura;

b) kanë marrë tokë, por që, me vendim të Këshillit të Ministrave, është cilësuar zonë urbane, për ndërtim hidrocentralesh, ujësjellësish apo për ndonjë veprimtari tjetër.

Në këtë rast vendbanimi i ri i këtyre familjeve përcaktohet me vendim të Këshillit të

Ministrave.

13. Trajtohen me ndihmë ekonomike familjet, që kanë ndryshuar vendbanimin, nga një qytet në një qytet tjetër, pas datës 1 gusht 1991, por, që në çastin e lëvizjes, kanë qenë të punësuar në vendbanimin e ri dhe, kjo gjë duhet të vërtetohet me kopjen e noterizuar të librezës së punës.

II. Procedurat për përfitimin e ndihmës ekonomike

14. Për gjendjen e familjes apo të anëtarëve të saj, që kërkojnë ndihmë ekonomike, administratorët shoqërorë, në bazë të listave, në bashki/komuna, kërkojnë informacionin e nevojshëm, nga institucionet e mëposhtme:

- Zyra e punës;
- Zyra e tatim-taksave;
- Zyra e sigurimeve shoqërore;
- Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (hipoteka);
- Zyra e regjistrimit të automjeteve;
- Seksioni pranë bashkive (urbanistika, tregu i lirë etj);
- Inspektorati i Punës.

15. Këto institucione duhet që, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, të dërgojnë informacionin e kërkuar.

16. Administratorët shoqërorë, sa herë e kanë të nevojshëm, kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përcaktuara në pikën 14 të këtij vendimi.

17. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, janë të detyruara të njoftojnë zyrtarisht, çdo tre muaj, administratorët shoqërorë të zyrave të ndihmës ekonomike në bashki/komunë, për të gjitha ndryshimet, në regjistrat përkatës.

III. Masa e përfitimit të ndihmës ekonomike

18. Masa e ndihmës ekonomike të plotë mujore, nga fondet e Buxhetit të Shtetit, përcaktohet në bazë të strukturës së familjes, si më poshtë vijon:

- a) Për kryefamiljarin shuma 2600 (dymijë e gjashtë qind) lekë në muaj;
- b) Për anëtarët e familjes në moshë pune e lart shuma 2600 (dy mijë e gjashtë qind) lekë në muaj;
- c) Për çdo anëtar tjetër të familjes, në moshë pune shuma 600 (gjashtë qind) lekë në muaj.
- ç) Për çdo anëtar tjetër të familjes nën moshë pune (deri 18 vjeç) shuma 700 (shtatë qind) lekë në muaj.

19. Masa e plotë e ndihmës ekonomike, pavarësisht nga përbërja e familjes, nuk mund të jetë më lartë se 7000 (shtatë mijë) lekë në muaj.

20. Masa e ndihmës ekonomike për prindërit e çdo fëmije, të lindur trinjak apo më shumë, është 3000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet deri në mbarimin e arsimit të detyrueshëm, por jo më shumë se 18 vjeç.

21. Masa e ndihmës ekonomike për çdo jetim, të përcaktuar në shkronjat “b” e “c” të pikës 1 të këtij vendimi, është 3000 (tre mijë) lekë në muaj.

22. Masa e ndihmes ekonomike mujore, të pjesshme llogaritet si diferencë ndërmjet nivelit maksimal të ndihmës mujore të plotë dhe të ardhurave faktike, që siguron familja.

Në këtë rast në të ardhurat përfshihen:

- a) Të ardhurat nga veprimtaria ekonomike;
- b) Të ardhurat nga çdo sistem i mbrojtjes sociale (shtetërore, private ose individuale), me përjashtim të të ardhurave, që marrin invalidët e punës, paraplegjikët e tetraplegjikët, të verbërit, prindërit e fëmijëve trinjakë e më shumë;
- c) Të ardhurat nga çdo lloj kapitali;
- ç) Të ardhurat nga toka (sipas kategorive të saj, që sigurohen nga bimët e arave, vreshtat, ullishtet, pemëtaria, me përjashtim të tokës në proces shkripëzimi), të cilat llogariten sipas koeficientëve të mëposhtëm:

Kategoritë e tokës									
Emërtimi	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX-X
Koeficientët e të ardhurave lekë/m ² në vit	9	8	7	7	5	5	4	4	3

d) Të ardhurat nga blegtoria, të cilat ndryshojnë sipas zonave, e që llogariten sipas koeficientëve të mëposhtëm:

Në zonat fushore Të ardhurat nga 1 lopë = 15 dele/dhi = 3 dosa = 5 gica = 20 zgjoje bletësh = 22 500 lekë/vit
Në zonat kodrinore Të ardhurat nga 1 lopë = 12 dele/dhi = 3 dosa = 5 gica = 20 zgjoje bletësh = 18 000 lekë/vit
Në zonat malore Të ardhurat nga 1 lopë = 10 dele/dhi = 3 dosa = 5 gica = 20 zgjoje bletësh = 13 000 lekë/vit

23. Nuk përfitojnë ndihmë ekonomike familjet, të cilat, pas llogaritjeve me koeficientët e mësipërm, marrin deri në 800 (tetëqind) lekë në muaj.

IV. Kushtëzimi i ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet

24. Bashkitë/komunat kanë të drejtë, që përfitimin e ndihmës ekonomike ta kushtëzojnë me punë e shërbime në komunitet. Projektet për kushtëzimin e kësaj ndihme me punë apo shërbime në komunitet mund të jetë me kohë të plotë pune ose me kohë të pjesshme pune, për disa ditë në muaj.

25. Bashkitë/komunat përcaktojnë fushat dhe përparësitë, ku do të zbatohen projektet për punë komunitare apo për shërbime shoqërore.

26. Këshilli bashkiak ose i komunës miraton një herë në katër muaj:

- a) projektet e punëve komunitare apo të shërbimeve shoqërore, me kohë të plotë pune;
- b) listën e personave, që do të marrin pjesë në zbatimin e projekteve, me kohë të plotë pune;
- c) objektet ku do të ndërhyet;

ç) kalendarin dhe vëllimin e punimeve për projektet, me kohë të pjesshme pune (disa ditë në muaj).

27. Nuk përfshihen në punë komunitare personat me aftësi të kufizuar, të përhershme apo dhe të përkohshme, si dhe ato mbi moshë pune, të cilët nuk kanë mundësi për të kontribuar në këto punë e shërbime në komunitet. Në këtë rast familjet e tyre vazhdojnë të përfitojnë ndihmë ekonomike, e cila llogaritet sipas pikës 18 të këtij vendimi.

28. Masa e pagesës së personave, pjesëmarrës në projektet e punëve e të shërbimeve në komunitet, me kohë të plotë pune, nuk duhet të jetë më e vogël se paga minimale në shkallë vendi.

29. Fondet e nevojshme për pagesën e pjesëmarrësve në këto projekte të sigurohen nga:

a) fondi i ndihmës ekonomike, që llogaritet sipas strukturës së familjeve pjesëmarrëse në këto projekte, por jo më shumë se 7000 (shtatë mijë) lekë në muaj;

b) të ardhurat e bashkisë/komunës, për pjesën tjetër të fondit, deri në nivelin e pagës minimale, si dhe për detyrimin për plotësimin e pagesës së kontributit si punëdhënës.

30. Familjet që marrin pjesë në këto projekte, pas përfundimit të projektit, kanë të drejtë të riaplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi.

31. Për punë e shërbime me kohë të pjesshme, disa ditë në muaj, ftohen në punë komunitare të gjithë anëtarët e aftë për punë të familjeve, që kërkojnë ndihmë ekonomike. Këto projekte mund të organizohen në bazë komune ose njësie bashkiake, por edhe në njësi më të vogla, në bazë fshati etj.

32. Këshilli bashkiak apo ai i komunës miraton listën e personave, që do të marrin pjesë në punë komunitare.

33. Masa e ndihmës ekonomike për familjet, që kryejnë punë e shërbime në komunitet, me kohë të pjesshme, llogaritet sipas strukturës së familjes, por, në asnjë rast, nuk mund të jetë më shumë se 7000 (shtatë mijë) lekë në muaj.

34. Njësitë e qeverisjes vendore, që kushtëzojnë shpërndarjen e ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet, raportojnë, përpara nisjes së projektit, në zyrën rajonale të shërbimit social shtetëror për:

- a) përshkrimin e gjendjes social-ekonomike në periudhën pararendëse;
- b) kategorizimin e familjeve, përfituese të ndihmës ekonomike;
- c) numrin e familjeve dhe të anëtarëve të aftë për punë, të cilët mund të kontribuojnë për punë

e shërbime në komunitet;

ç) numrin e familjeve, të personave me aftësi të kufizuar dhe për ato mbi moshë pune, të cilët nuk kanë mundësi për të kontribuar, për punë e shërbime në komunitet.

35. Njësitë e qeverisjes vendore, që kushtëzojnë shpërndarjen e ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet, vënë në dijeni zyrën rajonale të shërbimit social shtetëror për rezultatin e arritur nga punët dhe shërbimet komunitare, si dhe për administrimin e ndihmës ekonomike.

36. Fondet e ndihmës ekonomike nga Buxheti i Shtetit përdoren vetëm për programin e ndihmës ekonomike. Këto fonde nuk përdoren për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe të detyrimeve të tjera në rastet e aplikimit të projekteve të kushtëzimit të ndihmës ekonomike me kohë të plotë.

37. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore, bashki/komuna dhe qark, për zbatimin e këtij vendimi.

38. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të nxjerrin udhëzimet e nevojshme në zbatim të vendimit.

39. Vendimet nr.113, datë 31.3.2002 “Për ndihmën ekonomike” dhe nr.758, datë 13.11.2003 “Për pilotimin e shpërndarjes së ndihmës ekonomike të kushtëzuar me punë dhe shërbime në komunitet” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DEKLARATE E GJENDJES EKONOMIKE DHE SOCIALE TE FAMILJES

Viti _____

Kryefamiljari _____
 Emri Atesia Mbiemri

Numri i Sigurimit Shoqeror _____ Numri i Anetareve te familjes

☐

Adresa e Banimit _____

Numri i dokumentit te identifikimit _____

TE ARDHURAT QE SIGURON FAMILJA

1. Te Ardhura Nga Veprimtaria Ekonomike

(punesimi, vetepunesimi, pune e parregjistruar, pune prane nje anetari te vetepunesuar te familjes, biznesi i vogel privat, te tjera...)

(lloji i veprimtarise ekonomike qe kryejne anetaret e familjes)

Te Ardhurat _____ leke ne muaj

2. Te Ardhurat Nga Sistemi i Sigurimeve Shoqerore

(pension pleqerie, pension invaliditeti, pension familjar, pensione te tjera, pagese papunesie etj...)

(lloji i pensionit ose pagesa e papunesise qe perfiton personi apo familja)

Te Ardhurat _____ leke ne muaj

3. Te Ardhurat nga Emigracioni PO ☐ JO ☐

Te Ardhurat _____ leke ne muaj

4. Te Ardhurat nga Letrat Me Vlere (Bono, Aksione, Obligacione) ☐ ☐

Te Ardhurat _____ leke ne muaj

5. Te Ardhura nga Depozita ne Banke (Brenda, Jashte Vendit) PO ☐ JO ☐

Te Ardhurat _____ leke ne muaj

6. Trashegimi ne Vlere Monetare (Brenda, Jashte Vendit) PO ☐ JO ☐

Te Ardhurat _____ leke ne muaj

7. Te Ardhura Te Tjera

(nga qirate, shitjet e mjeteve dhe pronave te ndryshme, llogarite etj.)

(lloji i te ardhurave)

Te Ardhurat _____ leke ne muaj

8. Te Ardhurat Nga Prona, Perdorimi i Tyre nga Pronari Apo Persona te Tjere

	EMERTIMI	PO	TE ARDHURAT LEKE NE MUAJ	JO
a	Dyqan, Lokal Tregetimi, Sherbimi, Prodhimi			
b	Bar, Restorat, Hotel, Kioske			
c	Depo, Magazine, Hangar			
d	Parking, Garazhd, Servis, Lavazh			
e	Troje te ndryshme			
f	Automjete (Veture, Kamion, Autobus, Mikrobus, Autovinc, Zetor, Motokarro e te tjera)			
g	Mjete te thjeshtaTransporti dhe Kafshe			
h	Te tjera			

9. Te Ardhura Nga Bujqesia☐ ☐

	EMERTIMI	Siperfaqe m2	Kategoria	Te Ardhura leke ne muaj
1	Toke Are			
	Nga kjo sera			
2	Pemtari			
3	Vreshta			
4	Ullishte			
5	Kullote			
6	Pyll			
	GJITHSEJ			

10. Te Ardhura nga Blegtoria☐ ☐

Nr.	EMERTIMI	KRERE	TE ARDHURA LEKE NE MUAJ
1.	Gjedhe (lope)		
2.	Te imta (dele/dhi)		
3.	Dosa		
4.	Gica		
5.	Zgjua blete		
	Gjithsej		

TE DHENA TE TJERA SOCIALE SOCIALE

1.STERHIMI

Tipi i Banesës : Pallat ☐ Shtëpi perdhese ☐ Barake ☐ Vile ☐ etj _____.

KONTRATA E BANESES _____

Jeton ne :Banese me vete _____, Banese e perbashket _____, Baneses jo te vetem _____.

Numri i te ndareve 1 ☐ 1+1 ☐ 2 + ☐ 3+1 ☐

2.ARSIMI, PROFESIONI, PUNA

<u>Nr.</u>	<u>Emri Mbiemri</u>	<u>Arsimi</u>	<u>Profesioni</u>	<u>Data e shkeputjes nga puna</u>

3.Gjendja Shendetesore e Anetareve te familjes

4.Probleme te tjera Sociale te familjes

Probleme me te Miturit, Adoleshentet, te Moshuarit, Probelem te çiftit, keqtrajtime te anarateve te familjes, Shfrytezime, Abuzime etj.

KRYEFAMILJRI

Emri Mbiemri Firma

DEKLARATE E PARAQITJES MUJORE TE FAMILJES

Anetaret madhore te familjes kerkuese per ndihme ekonomike paraqitet nga data 1 deri 15 te cdo muaji prane administratoreve shoqeror ne baze te nenit 20 te ligjit Nr. 93550 date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore".

Kryefamiljari _____

Adresa e Banimit _____

PERBERJA DHE GJENDJA E FAMILJEVE

Nr.	Emri Mbiemri	Datelindja Dite muaj vit	Muaji	
			Lidhja me kryefamiljarin	Gjendja aktuale
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				

Shenim: Te kolona Gjendja Aktuale te shkruhet shenimi perkates per cdo anatar te familje Punesiar, I Vetpunesuar, I Papune, Pensionist, Nxhenes, Student, Familje, Ushtar, Ne spital, jashte shtetit, ne institucione etj

Kini ndryshim ne deklaraten e Gjendjes Ekonomike dhe Sociale te famijeve.

Po _____, JO _____

Ne rast se Po _____ shkruani ndryshimet perkatese

NE ANETAR MADHORE TE FAMILJES (mbi 18-vjec) PLOTESOJME KETE DEKLARATE NEN PERGJEGJESINE TONE PERSONALE DHE LIGJORE. NE RAST SE DO TE REZULTOJNE FAKTE TE KUNDERTA ME DEKLARIMET DO TE MBAJME PERGJEGJESI TE PLOTE SIPAS LIGJEVE NE FUQI.

Anetar Madhore te familjes
Emri Mbiemri Firma

Date _____ u mor ne dorezim nga Administratori Shoqeror
Firma _____

VENDIM
Nr.788, datë 14.12.2005

PËR PËRCAKTIMIN E AKSIDENTIT NË PUNË OSE PËR SHKAK TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aksident në punë ose për shkak të punës është dëmtimi i menjëhershëm trupor, i ndodhur gjatë kryerjes së punës ose gjatë një procesi, që ka lidhje me punën, si dhe çdo dëmtim tjetër i shëndetit, që nuk rrjedh nga sëmundje të përgjithshme, por që sjell paaftësi, të përkohshme ose të përhershme, në punë ose vdekje.

2. Aksidenti vlerësohet se ka ndodhur në punë ose për shkak të punës, kur personi i punësuar dëmtohet:

- a) gjatë kryerjes së punës së zakonshme;
- b) gjatë kryerjes së një pune tjetër, pa urdhër të punëdhënësit, por, për arsye madhore, në interes të punës;
- c) gjatë kreyrejs së një pune tjetër, me porosi të punëdhënësit;
- ç) gjatë kohës së pushimit, në vendin e caktuar ose për vënien në rregull të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, para ose pas mbarimit të punës;
- d) gjatë rrugës, në linjën e drejtpërdrejtë, nga banesa për në punë dhe anasjelltas, si në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësit dhe kur ai është individual.

3. Në çdo rast të një aksidenti në punë ose për shkak të punës, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, duhet të lajmërojë, brenda 3 ditëve, Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

4. Në rast të një aksidenti në punë ose për shkak të punës, me pasojë vdekje apo dëmtime të rënda masive, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, pas dhënies së ndihmës së parë, duhet të ruajë provat materiale, për analizën e këtij aksidenti, dhe të lajmërojë, menjëherë, organet e prokurorisë, Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

5. Kur aksidenti ka ndodhur gjatë rrugës nga banesa për në punë dhe anasjelltas, procesverbali i mbajtur nga organet e policisë, duhet të bëhet pjesë e dokumentacionit, për përfitimin e pagesës së aksidentit në punë.

6. Aksidenti në punë ose për shkak të punës vërtetohet me procesverbalin e mbajtur në vendin e ngjarjes dhe duhet të nënshkruhet nga punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, si dhe nga inspektori i punës, brenda tri ditëve nga ndodhja e aksidentit.

Forma e procesverbalit dhe udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij përcaktohen nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Për shkeljet sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi, punëdhënësi ose personi përgjegjës i ngarkuar prej tij, dënohen sipas kreut VIII “Procedura dhe sanksione” të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, të ndryshuar.

8. Vendimi nr.460, datë 22.7.1998 i Këshillit të Ministrave “Për aksidentet në punë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.789, datë 14.12.2005

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.240, DATË 13.4.2001 TË KËSHILLIT TË

MINISTRAVE “PËR NDARJEN E TË ARDHURAVE, QË RRJEDHIN NGA USHTRIMI I VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET E LICENCUARA PËR LOJËRA FATI, KAZINO DHE HIPODROME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Vendimi nr.240, datë 13.4.2001 i Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e të ardhurave, që rrjedhin nga ushtrimi i veprimtarisë nga subjektet e licencuara për lojëra fati, kazino dhe hipodrome”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.791, datë 16.12.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, në nenin 531 të seksionit 13 “Dhurata të dhëna në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare”, të kreut II “Rrethana të veçanta për të cilat jepet përjashtim nga detyrimet doganore”, të pjesës III “Përjashtime nga detyrimet doganore”, në shkronjën “ç”, pas shprehjes “...Forca të Armatosura”, të shtohet shprehja “...dhe strukturave të Policisë së Shtetit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468
Për më tepër informacion vizitoni faqen e internetit:
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1500
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	1200
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	1000
4. INDEKSI ALFABETIK	1000

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 23.12.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë